



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa
Legjislatura III
14 shkurt 2008
Prishtinë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 3 –të e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Mbledhja u mbajt më 14.02.2008 në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, në sallën C -203 dhe filloi në orën 13:00.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e shërbimit të Sekretariatit të Kuvendit, përfaqësuesit monitorues të USAID-it , OSCE-s, NDI-së dhe përfaqësuesit e ftuar të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRE), përfaqësuesi i bordit të ZRE Ali Hamiti, përfaqësuesit e Autoritetit të Rregullatorit të Telekomunikacionit (ART), kryetari i Bordit të AER-s Anton Berisha dhe përfaqësuesi i MEF Agim Krasniqi, drejtor i Buxhetit.

Thirrjes për mbledhje nuk i është përgjigjur Driton Tali, anëtar i Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komisionit, Gani Koci.

Kryetari i Komisionit e hapi mbledhjen dhe propozoi këtë:

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i kërkesave për buxhet të organizatave buxhetore për vitin 2008;**
 - 2.1. Zyra e rregullatorit për energji**
 - 2.2. Autoriteti i rregullatorit të telekomunikacionit**
 - 2.3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryeministrit të Kosovës për formimin e Zyrës për komunitete pranë zyrës së Kryeministrit.**

Pas konstatimit se rendi i propozuar i ditës u miratua, kryetari hapi diskutimin lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës.

2.1. Shqyrtimi i kërkesave për buxhet të organizatës buxhetore: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE)

Vërejtjet hyrëse mbi të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara për vitin 2008 i dha kryetari i Bordit Ali Hamiti duke treguar se Zyra e rregullatorit në formularin e saj për planifikim të buxhetit, që i është dërguar Komisionit për shqyrtim, i ka paraqitur të dhënat për buxhetin e vitit paraprak si dhe projekt dokumentin për vitin vijues fiskal. Kjo është në përputhje me nenet 19,20,21 dhe 22 të Ligjit mbi rregullatorin e energjisë.

Përmbajtja e zgjidhjeve të propozuara të projekt dokumentit u arsyetua pas kërkesës dhe vërejtjeve të kryetarit të komisionit Gani Kocit e Safete Haderxhonajt në vijat buxhetore të pagave dhe kompensimeve, mallrave dhe shërbimeve, të asistencës teknike, të avans llogarive dhe të raporteve mbi mjetet e shpenzuara për vitin e kaluar si dhe të vërejtjeve të Besa Gaxherit për kategorinë buxhetore të mallrave dhe shërbimeve – pozicioni i shërbimeve këshilldhënëse dhe intelektuale.

Pas deklarimit të shumicës së anëtarëve, Komisioni mori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni shqyrtoi formularin e shpenzimeve të ofruar nga ana e ZRE dhe propozon këto ndryshime:

- Pagat dhe mëditjet në shumë prej 314.420 €
- Shtesat për punë jashtë orarit, për mëditje dhe stimulim 86.625 €
- Mallra dhe shërbime 604.000 €
- Shpenzimet kapitale në shumën prej 40.000 €
- Shpenzimet komunale në shumën prej 15.500 €

Shpenzimet e përgjithshme të ZRE janë 1.062.545 €

2.2. Shqyrtimi i kërkesave për buxhet të organizatës buxhetore: Autoriteti i Rregullatorit për Telekomunikacion (ART)

Kryetari theksoi se një pjesë e Ligjit për telekomunikacion dhe e Ligjit për menaxhimin me financat publike e rregullon punën dhe veprimtarinë e ART-s dhe përcakton mënyrën e menaxhimit të mjeteve publike, të cilës i nënshtrohen të gjitha agjencitë që kanë qasje në mjetet publike, kështu që ky organ ka dalë nga Kuvendi si autoritet i pavarur jo profitabil brenda Ministrisë. Kryetari, gjithashtu, posaçërisht theksoi faktin se Kuvendi ka obligim që të caktojë buxhetin për këtë institucion, kurse me ligj (neni 5 dhe 6) në mënyrë të qartë sqarohet forma dhe mënyra e financimit të kësaj organizate buxhetore.

Pas shpjegimeve hyrëse të kryetarit të Komisionit, Komisioni bëri shqyrtimin e formularit të paraqitur të shpenzimeve të trupit rregullator (projektbuxhetit).

Kryetari i bordit Anton Berisha u përgjigj në shumë pyetje të deputetëve të cilat kishin të bënin me projektbuxhetin e propozuar, kurse Komisioni e vlerësoi arsyeshmërinë e kërkesave për buxhet në pajtim me ligjin.

Deputetja Safete Haderxhonaj gjatë shqyrtimit paraqiti disa vërejtje, të cilat kanë të bëjnë me raportet periodike të autoritetit të rregullatorit që nuk i kanë përmbushur standardet gjithëpërfshirëse të raportit financiar, kështu që në këtë formë kanë qenë jo komplet dhe të papranueshëm, pa pjesën e detajzuar financiare me shpjegimet tabelare të pozicioneve dhe të pjesës punuese. Gjithashtu, ka theksuar se mungojnë të dhënat për atë se çka ka realizuar ky organ, si është shpenzuar buxheti nga viti i kaluar si dhe indikatorët mbi të ardhurat që do të realizohen në buxhet dhe pas kësaj do të përcaktohen shpenzimet.

Pas deklarimit të shumicës së anëtarëve, Komisioni mori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni shqyrtoi formularin e shpenzimeve, të ofruar nga ana e ART dhe propozon këto ndryshime:

- Pagat dhe mëditjet në shumën prej 222.279, 40 €
- Mallrat dhe shërbimet në shumën prej 4.08.000 €
- Shpenzimet komunale në shumën prej 12.300 €
- Shpenzimet kapitale në shumën prej 1.600.000 €

shpenzimet e përgjithshme të ART-së arrijnë 242.579,40 €

2.3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryeministrit të Kosovës për formimin e Zyrës për komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit.

Duke përkrahur konceptin buxhetor të kërkesës së Kryeministrit të Kosovës për formimin e Zyrës për komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit dhe duke e konsideruar këtë si të domosdoshme, komisioni mori këtë:

PERFUNDIM

Në tabelën A, nga kodi i programit 216 – Autostrada, korridori C-D zbritet shuma prej 1 milion € dhe kjo transferohet në kodin organizativ 104 – Kabineti i Kryeministrit, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transferime.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30

Njësia për komisionet parlamentare

Kryetari i Komisionit
Gani Koci